

Greta JANI  
Universiteti "Aleksandër Moisiu"  
Fakulteti i Edukimit  
Departamenti i Gjuhës Shqipe  
Durrës, SHQIPËRI  
Email: greta\_jani@yahoo.com

## DUKURI GJUHËSORE NË PUBLICISTIKËN E PËLLUMB KULLËS LINGUISTIC PHENOMENA IN THE PUBLICISTIC OF PËLLUMB KULLA

### Hyrje

I ftuar në një nga emisionet televizive, organizuar dhe drejtuar nga analisti Mustafa Nano, shkrimtari, regjisori, diplomati, Pëllumb Kulla, i përgjigjet kështu, një prej pyetjeve të intervistës:

*M N -Gjuha shqipe u duket e pasur, e varfër, apo si të tjerat?*

*P K-Gjuha shqipe është e pasur si drithi i bollshëm në hambarë, por i hedhur atje i pashoshitur.*

Ky vlerësim i Pëllumb Kullës për gjuhën shqipe, si edhe pasuria e krijimtarisë së tij në fusha të ndryshme të artit, letërsisë e publicistikës, janë pikënisja e vështrimit tonë mbi disa veçori gjuhësore e stilistike të veprës së tij më të re, të titulluar *Luftë pa fund*.

Vepra *Luftë pa fund* është një përmbledhje e disa shprehurive të autorit me tema e gjini të ndryshme; nga fusha e politikës, autori sjell artikuj e fjalime botuar pas përmbysjes së komunizmit në Shqipëri; nga fusha e diplomacisë, libri përmban fjalimet e Kullës në OKB, si edhe letra drejtuar miqve të tij politikanë, burra shteti, diplomatë apo gazetarë; nga fusha e artit, në libër gjejmë krijime satirike, tregime humoristike, skeçe, fejtone; nga fusha e publicistikës gjenden aty shkrime ku autori skicon portrete të figurave të shquara jo vetëm brenda, por edhe jashtë vendit

tonë, si ai i Nënë Terezës, Putinit, Haradinajt, Rugovës, Bushit, Obamës, enveristët kosovarë, Gynter Grassit etj.

Shkrime të natyrave të ndryshme, të mbështjella nën një kope-rtinë, “të lexuara” tani gjuhësisht, do të na japin mundësinë për ta njohur në një dimension tjetër të ri autorin, për të vazhduar me befasinë nga begatia dhe zhdërvjelltësia e gjuhës së tij, për të vlerësuar përkujdesjen dhe punën e palodhur që ka bërë me gjuhën, gjë që e ndjen sa herë të duhet të kalosh nga një shkrim në tjetrin apo të fluturosh nga publicistika te portreti pa ndjerë turbulencë gjuhësore e kuptimore.

### **Pak fjalë për autorin**

Liqeni njihet përmes notit, njeriu përmes të folurit, e shkrimtari përmes shkrimeve që ngutet t’i ndajë me të tjerë.

Po kush është Pëllumb Kulla?

E shoh me vend në hyrje të këtij punimi të shkruaj pak rreshta për autorin.

Pëllumb Kulla gëzon famë ndër shqiptarët brenda dhe jashtë Shqipërisë si shkrimtar, regjisor e publicist. Ai është njeriu që jetën e tij ia përkushtoi artit, teatrit, satirës, politikës e publicistikës. Regjisor në Teatrin dhe Varietenë e qytetit të Vlorës, më pas të Fierit, e më pas në Televizionin Shtetëror, ka dhënë vepra më vlerë që janë ende në repertorin aktiv kombëtar dhe në arkivin e përdorshëm të kanaleve televizive; autor i pesëmbëdhjetë librave, shumë dramave dhe komedive, si edhe dy skenarëve filmikë të realizuar; në vitin 2003 është vlerësuar dhe dekoruar si “Mjeshtër i Madh”.

Këtij shkrimtari e mjeshtri të madh i kemi detyrim, pasi jemi tre-guar të njëanshëm, kemi trumbetuar me të madhe vlerat letrare të veprës së tij e kemi lënë paksa pas dore ato gjuhësore, ndërkohë që krijimtaria e tij letrare e publicistike e mbarsur me këto vlera ka kohë që botohet edhe në gjuhë të tjera, si: italisht, greqisht, gjermanisht e anglisht.

Jemi krejtësisht kundër mendimit të autorit, që *“ky nuk është nga ata libra që nuk lëshohet nga dora”*, pasi edhe pse ka pasur një peshë fizike të konsiderueshme për një libër, kërshtëria dhe interesi nga njëra anë, që zgjon jeta publike e këtij artisti, politikani dhe publicisti që *si një diktator sundoi për njëzet e katër vjet në publikun shqiptar, siç shprehen Filip Çakuli e Mero Baze në parathënie të veprës*, por edhe bukuria e logjika e frazës në vepër nga ana tjetër, të bëjnë të mos e lëshosh nga dora librin pa i dalë në fund duke kuptuar më mirë autorin, marrëdhënien e tij me pushtetin, politikën e re dhe të vjetër, profesionin, gazetarët, miqtë e bashkëkohësit njerëz fatkeq e fatmirë, të gjitha këto përmes një shqipeje të pasur e të përdorur me mjeshtëri.

## Gjuha e shkrimtarit, çështje e vetëdijes kombëtare, e vlerës sonë

Studimi i gjuhës së veprës së një shkrimtari kushtëzohet shumë nga natyra e veprës së tij. Gjuha e shkrimtarit nuk është vetëm çështje estetike, letrare, filozofike, por edhe çështje sociale, morale, çështje e vetëdijes kombëtare, e vlerës sonë, siç është gjithmonë pasqyrim ose pamje e gjallë e marrëdhënieve tona njerëzore, mendore, intelektuale.

Shkrimtarët përdorin gjuhën si instrument me të cilin ata realizojnë idetë dhe qëllimet e veta artistike. Vetë autori thotë se ka treguar kujdes ndaj gjuhës, përsosjes së saj, pasi materiali përmbajtësor ka qenë shpërfaqur e botuar në shtypin e kohës, korrespondencat e miqve, intervista gazetarësh apo fjalime të mbajtura në mbrëmje solemne.

Siç thekson J. Parandovski “kush nuk e dashuron gjuhën me të cilën krijon, nuk do të bëhet kurrë artist, madje as shkrimtar i mirë” (Parandovski 1964). Gjithashtu është e domosdoshme njohja e veçorive stilistike të gjuhës dhe potencialit shprehës të saj për të arritur mjeshtërinë e të shkruarit.

Pëllumb Kulla e bën këtë në mënyrë shumë të vetëdijshme, si një shkrimtar i afirmuar tashmë, ngaqë ai nuk përton ta gurmtojë fjalën e cila më shumë i përgjigjet dhe pasqyron atë që do të shprehë, prandaj mendimet dhe ndjenjat janë shprehur me saktësi e përpikëri të madhe edhe të ndërtuara stilistikisht e përsosmërisht.

Në kohët e sotme gjuha e veprave publicistike dhe e shtypit kanë afrim të ndjeshëm me gjuhën e gjallë dhe kjo jep frytet e veta si rruga kryesore për të shmangur frazeologjinë e zbrazët, shabllonet, përsëritjet, shprehësinë e konsumuar e letrarizmat.

Gjatë leximit të kujdesshëm të veprës *Luftë pa fund* vihet re se si bashkohet logjika e shëndoshë me bukurinë e artit të fjalës, gjerësia e thellësia e trajtimit të përmbajtjes me larminë e formës e mjeteve të shprehjes. Çdo gjë përdoret në vendin e vet: figurat gjuhësore, frazeologjia, leksiku popullor, terminologjia profesionale tipike për natyrën e shkrimeve të gazetës, ruhet ekuilibri stilistik çka bën që faqet të lexohen shpejt me ëndje e kënaqësi.

E shkruar në gjuhën letrare të njësuar, vepra dëshmon edhe për këmbënguljen e vazhdueshme të autorit, që kjo gjuhë të jetë sa më e pasur në mjete shprehëse, me të gjitha ngjyrat e vlefshme për të shprehur, ashtu siç duhet të gjitha mendimet dhe qëndrimet e tij, buzëqeshjet dhe buzëmbledhjet, shpërthimet emocionale dhe heshtjen.

### Shumësi i emrave me -ra

“Gjuha jonë burimin e vet të pashtershëm e ka në popull” (Koliqi 5, 2003: 297), shprehet Ernest Koliqi, ndaj me bindje themi se shkrimtarët që

e njohin mirë gjuhën e popullit, që thithin pa pushim nektarin e ëmbël të saj, dinë mirë edhe normat e shqipes standarde, si edhe pikat ku mund të bëjnë shmangie e thyerje artistike të tyre.

Padyshim, kjo vlen edhe për autorin tonë, pasi që në faqet e para të librit të bie në sy përdorimi i shpeshtë i shumësit të emrave me *-ra* në vepër. Ky përdorim është jo normë, është thyerje e qëllimshme e saj, pasi emrat e mëposhtëm ose e bëjnë shumësin njëlloj si njëjësi ose e bëjnë me *-ë*, si p.sh.: (një) kredi-(ca) kredi apo (një) milioner-(ca) milionerë etj.

Autori përdor shumësin me *-ra* për të krijuar efekt stilistik, me qëllimin për të ironizuar, fshikulluar e shpotitur duke mos kursyer sistem e njerëz, ngjarje e fenomene që nuk i kanë shpëtuar syrit të tij prej mëmëdhjetari-intelektual e njëherësh edhe si mjeshtër i satirës. Veçojmë fjalët: *kusarira, milioniera, kryesira, gjallcëra, herezira, kancelarira, Strasburgëra dhe Uashingtonëra etj.*

### Kompozitat

Gjuha e një shkrimtari paraqitet si një sistem fjalësh dhe mënyrash të thëni të organizuara në mënyrë origjinale ku shquan vetjakësia (individualiteti) e elementeve të ndryshme gjuhësore (Shkurtaç 2009: 28).

Çdo fjalë në gojën e autorit ka strukturë të gjerë kuptimore, por në fjalët e bashkuara, në fjalët kompozita, fjalëkrijime të autorit, kuptimi është më i dendësuar e i mëvetësishëm, me forcë të madhe shprehëse.

Në fushëkrijimtarinë gjuhësore Kulla do të shquhet edhe për kompozitat e shumta e të larmishme. Ai është tepër origjinal në krijimin e tyre dhe jep kështu një kontribut të madh në pasurimin e shqipes letrare. Të tilla janë: *shpifografon (shkruan shpifje), krimmilionieri, gjysmëbota, partibija, shtetëzimkolektivizimi, tentakulatpompa, dhjetramijëra, leqevënësi, shegertëtlo, maskazinjtë, pusbodrumi, fluturoreportazhi, vramendja, vetë-tallja, kafshimjargosja etj.* P.sh:

“Duke mos praktikuar **vetë-talljen**, ata në krye të vendit shpallin tërthorazi si herezi çdo vërejtje apo përqeshje që bëhet në kurriz të tyre”.

“Arkëtarët **syçaplyer** e **duarpërpyetë** ndiqnin debatin se cilës bandë grabitëse duhet t’i dorëzonin paratë”.

Shumica e neologjizmave kompozita i përkasin shtresës së fjalëve abstrakte nga marrëdhëniet e llojllojshme si dhe janë përcaktime me ngjyrim kryesisht keqësues për njerëz të angazhuar në keqbërjen e politikës, dhe jo vetëm.

Sipas vlerës leksiko-gramatikore fjalët e përbëra janë fjalë:

(a) me vlerë mbiemërore (të nyjëzuara): e *prapaperdeve*, e *shumëndërruar*, të *leqëdridhur*, e *prapaferrave*, e *shumëpërçarë etj.*;

(b) (të panyjëzuara) *kartonangritës, komitetoqëndroriale, frikëndjellëse, turlilloj, tjetërllor, vragalënëse, halleshumë, ballënxirosës etj.;*

(c) me vlerë emërore: *çerekshpifje, theqafje, çanakpërmbysës, rrezikzinj, pasojamadhi, fillimkorriku etj.;*

(ç) me vlerë foljore: *u gjithëpranua etj.;*

(d) me vlerë ndajfoljore: *qëllimmirë, qëllimkeqe, bukurmirë, emërmirë etj.*

*Bukur dhe mirë* janë dy ndajfole që kanë kuptimet e tyre përkatëse në gjuhën shqipe, por njëfjalësimi *bukurmirë* (ndajfolje) ka kuptim më të ngjeshur e të dendur, pasuron ndjeshëm fjalësin e shqipes dhe shquan origjinalitetin e autorit. Po kështu, prirje për sintetizim leksikor vihet re edhe në togjet *ngritës kartonash, moral i prishur, gojë e mprehtë apo gojë e kyçur etj.*, në fjalët e mësipërme që tregojnë për një parapëlqim të formave sintetike kundrejt atyre analitike.

Nga sasia e madhe e kompozitave të përdorura në vepër vihet re që autori e ka mjeshtëri fjalëformimin, kyesisht sipas modeleve popullore p.sh: krahas kompozitave popullore *halleshumë, ditëziu, ditëpreri etj.*, që ai përdor, krijon edhe vetë kompozitat: *shpifografon, komitetoqëndroriale, kapakuqe, fillimkorriku, partibija, shegertëtlo etj.*

Gjithashtu, mjaft kompozita kanë në përbërje të tyre temën *mani*, si: *efektomani, përfaqësimomani, citatomani, dritomani, armikomani*, të përdorura në situata të caktuara për të stigmatizuar dukuri e njerëz të sëmurë e me vese të cilët herë të dhimbsen e herë të tjera të neveriten. Po kështu, edhe me fjalën *mega* autori krijon: *megapërbuzje, megashpërdorim, megamashtrim etj.*, për të treguar të shumëfishuar përmasat e fenomeneve e gjendjeve negative, ndaj të cilave Kulla mban qëndrim të prerë e serioz.

### **Kompozitat me vizë në mes**

Edhe kompozitat me vizë në mes i hasim shpesh në rreshtat e prozës së autorit. Ato janë të gjitha falëkrijime të autorit, të cilat pasurojnë ndjeshëm leksikun e gjuhës shqipe dhe sjellin kuptime të fuqishme në këto shkrime. Të tilla janë: *bashkë-fajin, gjasme-përmbysje, gjasme-diktaturë, xhuxh-dimensioni, kompani-ushunjëza, ballisto-zogiste, bukuroshet-mise, krimineli-kanakar, binjak-hije, deputeti-karton-mbajtës etj.*

Përgjithësisht fjalët përbërëse të këtyre ndërtimeve janë emra, por edhe ndajfolje, si: *telefon-kthimi, dëshmi-libër, artisti-hero (emra), mish-mash, fare-fare pak (ndajfolje)* e rrallë edhe kombinime ndajfoljesh me përëmbra, apo lidhëza e numërorë, si: *pak-kush, ca-pak (vuajtje), as-edhe-një etj.*

## Mjetet gjuhësore me funksion karakterizues, përshkrues e cilësues

Një e veçantë tjetër e stilit të autorit është përdorimi i mjeteve të shumta gjuhësore me funksion karakterizues, përshkrues e cilësues.

Krahasimi, i ndërtuar thjesht është aq i bukur e shprehës. P.sh.: *si re karkalecash në një arë me grurë, në cep të Ballkanit, si vreri në mëshikëzën e tëmthit, si kreshpërim instiktiv, kujtesa si ndonjë dhi e egër, këmbëngulin si mushka në këtë gjethnajë fiku, etj.* P.sh:

*E imagjinuar bukur është si kreshpërim instiktiv i Berishës ndaj shfaqjes së kësaj kandidature të bezdisshme, ashtu edhe pleqësimi i mëvonshëm që do t'i bëjë ai asaj. (457) E megjithatë parlamenti vazhdon punën, deputetët ngrenë dhe ulin kartonat dhe populli ende vazhdon e shikon me shpresë këtë brez burrash që ka zbritur si re karkalecash në një arë me grurë në cep të Ballkanit! (581) Por, ashtu si dritëhijet në trurin e sëmurë të diktaturës, i hiqej kjo e drejtë për një kohë, dhe më pas grishej të luante përsëri aty.*

Në këtë hulli të kësaj prirjeje, ai përdor edhe krahasime të ndërtuara sipas gjedheve popullore në shqip, si: *si miu në dhokan, si kërpudhat pas shiut, sikur patë mbirë nga dheu, si mizat në letrën e mjalit, si gjilpëra në kashtë, vdisnin si pulat, të cilat mbartin edhe ngjyime emocionale shprehëse e stilistike.*

Gjithashtu autori në funksion të përshkrimit e karakterizimit krijon togje emër + mbiemër (cilësor ose marrëdhënior) që në bazë të zhvillimit e lëvizjes kuptimore bien në sy si shprehje të figurshme, si: *individë të dliësuar, duartrokitjet shurdhuese, zhurmërimet e bujshme, mëri të helmët, kostumi i mermertë, veturë indiferente, zë të zvargur, jetë të helmët, fantazi e çartur, papunësi e lumtur, mendje të drunjëta, ditë të hirta, opozitë të flashkët, përmbytjen e betontë etj.*

Është me rëndësi të nënvizojmë se duke shfrytëzuar mundësitë e shqipes autori ka pasuruar me fjalëkrijime, kuptime, shprehje origjinale leksikun e gjuhës shqipe duke u përpjekur të na tregojë se publicistika në përgjithësi, dhe ajo letrare në veçanti, nuk ia arrijnë dot qëllimit pa mjetet e shprehjes letrare.

Gjuha e tij e shkathët, mprehtësia e thënies, freskia e mjeteve të figurshme, frazeologjia janë lënda e parë e të gjitha shkrimeve në vepër duke krijuar kështu edhe një mozaik gjuhësor specifik, sa të bukur, aq edhe origjinal.

## Fjalët e prejardhura

Gjuha e përbashkët letrare ka marrë e merr nga ligjërimi popullor shumë fjalë jo të parme, të panjohura ose pak të njohura për të. Është e vetëkuptueshme që bashkë me to vijnë në gjuhën letrare edhe mjetet me të cilat ato janë formuar (Shehu 1989: 340). Edhe në vepër kemi konstatuar shumë fjalë të prejardhura të cilat janë një kontribut i çmuar për gjuhën shqipe.

Mënyrat e mjetet e formimit të fjalëve të reja te Kulla, ashtu edhe modelet e këtyre formimeve që janë gjallëruar në mënyrë të veçantë këtu, janë: parashtesat dhe prapashtesat.

(a) **Neologjizmat me parashtesa.** Autori shfrytëzon gjedhet e fjalëformimit të shqipes. Ato janë më të pakta se formimet me prapashtesa e me kompozim. Të tilla janë: **ç-**, **-kundër**, **m-**, **mbi-**, **mos-**, **ndër-**, **nën-**, **pa-**, **për-**, **ri-**, **stër-**, **sh-**, **zh-** etj.

**ç-**: *çkëshillojnë;*

**kundër-**: *kundërkëmbim;*

**m-**: *e mveshur;*

**mbi-**: *mbitarraca;*

**mos-**: *mosrrezikimi, mosvizitë;*

**ndër-**: *ndërmendje, ndërfolësi, ndërluftues;*

**nën-**: *nënfletushka, të nënzëshme;*

**pa-**: *i pazhurmshti, e pabukë, të palarta, e pabujshme, paburrëri;*

**për-**: *përfytjen, përçafet, (e )përnxirë, (i )përndezur, përngahera, (e) përdhjamur, përngritën, përhiron;*

**ri-**: *riprivatizime, ritrimërim;*

**stër-**: *të stërshkelura;*

**sh-**: *shfronësim;*

**zh-**: *zhburrëruar, zhvatur, zhdedh etj.*

Numri më i madh i fjalëkrijimeve del me parashtesat **për-** dhe **pa-**.

(b) **Neologjizmat me prapashtesa.** Fjalëkrijimet me prapashtesim janë të shumta dhe mjaft të larmishme. Më të shpeshtat janë me prapashtesat: **-al**, **-an**, **-ar**, **-as**, **-çi**, **-ëri**, **-esk**, **-ës**, **-ësi**, **-[z, -ik, -im, -is, -ist, -istik, -izëm, -izim, -jot, -ke, -li, -llëk, -lli, -o, -oide, -on, -or, -ore, -os, -osur, -oze, -shëm, -shm[, -tçe, -tshe, -th, -uc, -uan, -uar, -xhi, -xhinj, -zo etj.**

**-ak**: *çmendurak etj.;*

**-al**: *kiriurgjikal, kronikal etj.;*

**-an(e)/(ë)**: *brezhnjevicane, berishjan, millosheviciane, squllan etj.;*

**-ar**: *fshesar, pasunar, pëlqimtar, etj.;* **-as**: *demokratikas etj.;*

**-çi**: *merakçi etj.;*

- esk: donkishotesk, farsesk etj.;
- ës: klithës, flakaritës, brengosës, nanuritës;
- ëri: qesharakëri, binjakëri etj.;
- ësi: rrallësi etj.;
- ëz: rrudhëz, njëzë etj.;
- ik(e): maratonike, mediatike, anekdodike, emblematik etj.;
- im: kërpudhim, turpërim, fisnikërim etj.;
- is: tellallis etj.;
- ist: nanoist, berishist, reformist, byroist etj.;
- istik: memorialistik, volejbollistik etj.;
- izëm: teatralizëm, mëmëdhetarizëm, liliputizëm etj.;
- izim: dëshmorizim etj.;
- jot: athinjot etj.;
- li: sedërli etj.;
- llëk: mysafirllëkut etj.;
- lli: mendjelli etj.;
- on: masakron, muzikon, mitralon etj.;
- or: dhelpëror etj.;
- ore: pleqërore, tempullore, akuzatore, fushatore etj.;
- osur: të lepurosur, të përmallosur, i handakosur etj.;
- shëm: rrejtshëm, ethshëm, fisshëm, dhunshëm etj.;
- th: libërth, shpërthimth, nxitimth, zjarrth etj.;
- uan: gjasmesuan etj.;
- uar: korracuuar, akademizuar etj.;
- xhi: shakaxhi, vërejtjexhi etj.;
- xhinj: kioskaxhinj, sherrxhinj etj.;
- zo: trupëzo, alibizo etj.

Vihet re që autori përdor rëndom fjalë me prapashtesa të huaja turke, si: -çi, -llëk, -ist, -xhi, -xhinj, etj., për të ironizuar e satirizuar, dukuri apo njerëz të sferës politike që me mentalitetin e prapambetur e veprimet e tyre janë bërë të bezdisshëm e qesharakë.

### Fjalët e përngjitura

Edhe fjalët e përngjitura përbëjnë një grup fjalësh me interes në vepër, të cilat meritojnë vëmendje në këtë studim. Shpesh lidhëzat, foljet apo edhe lokucionet emërore, ndajfoljore, numërore e përemërore, që dalin në përdorim pranë njëra-tjetrës njëfjalëzohen nga autori, i cili krijon kështu neologjizma tepër shprehës e të veçantë. P.sh.: *ec e ngec = ecengec*, *kush e di çë = kushediçë*, *ca nga ca = cangaca*, *kujt do = kujtdo*, *përse do = përsedo*, *as edhe një = asedhenjë*, *e aq pritur = e aqpritur*, *as edhe = asedhe*, e



*një herë një kohë = e njëherënjëkohëshme, fije për pe=fijepërpe, para ca ditëve=paracaditëve etj.*

### **Ndajfoljet me prapashtesën –isht**

Ashtu siç është karakteristike për gjuhën e publicistikës, në përgjithësi, edhe në gjuhën e veprës *Luftë pa fund*, një përdorim të gjerë gjejnë ndajfoljet me prapashtesën –isht (here - herë e zgjeruar) në formim ndajfoljesh të mënyrës si p.sh.: *forcërisht, ndërkombëtarisht, mjerisht, katërcipërisht, përsosmërisht, dëshpërimisht, paqësisht, llahtarisht, shembullo- risht, dhembshurisht, besnikërisht, rrënjësisht, tipikisht, politikisht, diamet- ralisht, poshtërsisht, verbërisht, pashmangshmërisht, solemnisht, kombëta- risht, shterpësisht etj.*

Me përdorimin e këtyre ndajfoljeve, Pëllumb Kulla, dëshmon se është njohës i shkëlqyer i traditës dhe i mbështetur në të ai krijon kalke të reja. Disa prej tyre të kujtojnë personalitetet më të ndritur të kombit tonë, jo vetëm të fushës së letërsisë, por edhe të gjuhës sonë: Fan S. Nolin, L. Poradecin dhe I. Kadarenë.

Prapashtesa –(i)sht formon ndajfolje duke iu prapangjitur temave emërore të cilat mund të jenë fjalë të prejardhura me prapashtesa të ndry- shme si: *gjakësisht, ndershëmërisht etj.*, ose dhe fjalë të para si: *mjerisht, hi- pokrizisht, lumturisht, dëshpërimisht etj.* Ajo u ngjitet edhe temave mbi- emërore, si: *kombëtar, triumfal, absolut, specifik etj.*

Gjithashtu ajo u prapangjitet edhe emrave femërorë që janë for- muar me prapashtesën –i, –(ë)ni, –ë(ri) ose që kanë si zanore fundore tin- gullin –i duke dalë kështu prapashtesa në trajtën e saj origjinale –sht. Psh.: *forcërisht, katërcipërisht, përsosmërisht, qesharakërisht, ndershëmërisht, mizorisht etj.* Fjala që është bërë ndajfolje duke marrë këtë prapashtesë mund të jetë edhe një kompozitë ose një formim me prapashtesë të tilla si: *katërcipërisht, palëkundshmërisht etj.*

Ndajfolje me –(i)sht janë formuar edhe nga emrat që janë formuar me prapashtesën –ë(si), si: *paqësisht, drejtësisht, tërësisht, vërtetësisht, ek- zaktësisht, thellësisht, gjakësisht etj.*

Nga tema mbiemërore si: *ndërkombëtarisht, mjerisht, literalisht, potencialisht, publikisht, elektoralisht etj.*

Nga emrat që janë formuar me prapashtesën –im: *dëshpërimisht, shkurtimisht, vazhdimisht, përfundimisht, gabimisht etj.*

Janë përdorur edhe ndajfolje të cilat janë formuar mbi një temë që nuk ekziston më vete e shkëputur nga prapashtesa, por që në vepër gjejnë përdorim të gjerë. Të tilla janë: *forcërisht, katërcipërisht, rrënjësisht, dia- metralisht etj.* Ky përdorim i ndajfoljes me –(i)sht është kthyer në tipar stilformues të autorit.

## Sinonimia

Sinonimia është një dukuri gjuhësore që të bie në sy, ndërsa lexon rreshtat e kësaj proze. Prof. J. Thomai pranon se sinonimet janë fjalë të ndryshme me kuptim të njëjtë a të afërt, duke pasur dy-tre a më shumë fjalë që shënojnë të njëjtin send, të njëjtin tipar, të njëjtin veprim apo të njëjtën dukuri (Thomai 1999: 239).

Ndërsa studiuesja kosovare, Sh. Islamaj, në punimin “Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe” ndër të tjera, pohon se “sinonimet janë fjalë me kuptim të njëjtë apo fjalë të ndryshme për nga përbërja tingullore dhe nga origjina, por të afërta apo të njëjta për nga kuptimi, të cilat shërbejnë për dallimin e nuancave kuptimore a stilistikore” (Islamaj 1985: 9-11), apo “sinonime konsiderohen fjalët të cilat kanë një domethënie të njëjtë leksikore dhe dallohen vetëm nga nuancat kuptimore, nga ngjyrat ekspresive dhe nga përkatësia e njërës apo e tjetrës sferë stilistikore, që kanë deri diku një përputhshmëri të plotë a të pjesshme, kështu që në kontekste të caktuara janë të zëvendësueshme (Islamaj 1985: 9).

Pasuria sinonimike është një nga vlerat më të mëdha të veprës, që tregon pasionin e dashurinë e autorit për gjuhën shqipe, gjuhë e cila i ka dhënë mundësi të mëdha autorit për të përdorur shumë fjalë me kuptim të afërt, por me një ngjyrim të fortë emocional. Duket që ai njeh mirë kuptimet e fjalëve pa arrin edhe t’i përdorë drejt ato. Gjuhëtari Stephen Ullman pohon, se sinonimia e plotë nuk ekziston, por ka sinonimi në nomenklaturën teknike (Ullman 1962: 29-34).

Të gjitha fjalët që kemi dalluar si sinonime sjellin kuptim të njëjtë logjik, por sjellin edhe vlera të ndryshme shprehëse-emocionale. Këto çifte sinonimike janë një mjet i fuqishëm në fushën e sinonimisë dhe tregues i një gjuhe të pasur, veti e çmuar e Kullës.

Nga materiali që kemi vjelë theksojmë se çiftet sinonimike nuk janë një përsëritje e thjeshtë, por e plotësojnë e konkretizojnë njëra-tjetrën, si emrat: *laçkë e plaçkë, me ashk e me zjarr, klithma e kuisje, shend e verë, hir dhe madhështi, etj.* Apo foljet dhe format e pashtjelluara të tyre të tipit: *nisnin e vinin, përzjerë e ndragur, shau e kërdisi, për të lehur e lllomotitur për t’u ngjizur e ngjitur, ka sharë e përfolur etj.* Por mund të jenë edhe shprehje e idesë me shkallëzim, si: *hidhërim e revoltë(emër), qit e prit, duke tjerë e stërrtjerë, i pati e më pas i bori, i talli e i përtalli, tundur e shkundur, premtoi e stërpremtoi, nisin e rinisin, u shfaqën e u rishfaqën, të ngriheshin e të iknin, shau e shau sa u ngop (folje) etj.*

Një veçori tjetër e gjuhës së autorit është edhe përsëritja për të përforcuar kuptimin dhe për t’i dhënë shprehësinë e duhur tekstit si: *përshkënditur e përshkënditur(pjesore), ndotur e ndotur (pjesore), fshikulluan*

e fshikulluan(folje), duke u rritur e rritur(folje), gradim e gradim të lartë (emër), ajkën e ajkës së rrëfimeve(emër), u shkund e u shkund(folje), fshikullues e fshikullues(folje), Kush kuptoi, kuptoi (folje) etj.

Jo vetëm larmia në çiftet sinonimike, por edhe denduria e përdorimit të këtyre çifteve është tipar dallues i veprës së Kullës. Mjeshtëria për të folur e shkruar arrihet nëpërmjet zotërimit të sinonimisë.

Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe vargje sinonimesh me tre a më shumë fjalë të cilat krijojnë idenë e të shtënave të njëpasnjëshme. Ato nuk të lënë të ikësh për asnjë çast nga ideja që kërkon të theksojë autori si p.sh.: *Pushtimi më i egër, më i rëndi e më i përgjakshmi ka qenë ky. Ca qënie të habitura, të gënhyera e të mashtruara. Grekët i rrahën, i shkëlmuar, i gënhyen, i përbuzën, i shfrytëzuan dhe i dëbuan! ...llahtari, barbari, prapësi, llumëri! Të shumtë janë tek ne njerëzit, që të lodhur e të drobitur, të fyer e të përtallur, e ndjejnë që kjo liri nuk paska qenë dashur fare. E rrethon statujën, i vë litarin, e heq zvarrë, e përdhos, e pështyn...etj.*

Në ndërtime të tilla duket ndikimi nga stili nolian. Ashtu si Noli, edhe Kulla synon të jetë i drejtpërdrejtë në publicistikën e tij. Qëndrimi i prerë dhe reagimi i menjëhershëm ndaj ngjarjeve të ndryshme si brenda dhe jashtë vendit shprehet përmes një gjuhe të pasur, veç të tjerash edhe me sinonime.

### Antonimia

Edhe pse më të pakta janë në numër, nuk mund të lëmë pa përmendur dukurinë e antonimisë. Antonimet janë fjalë me kuptime të kundërta. Tek antonimet kemi të shënuar të kundërt që jepen me shënues të ndryshëm. Fjalët antonimike mohojnë njëra-tjetrën në mënyrë të ndërsjellë dhe në të njëjtën kohë parakuptojnë njëra-tjetrën.

Prof. M. Samara që është marrë drejtpërdrejt me antoniminë, pranon se antonimet janë gjymtyrë të një grupi a vargu tematik ose elemente të një fushe semantike, por të lidhura nga karakteri i kundërt i kuptimit të tyre (Samara 1985: 42).

Parashtesa *mos-*, *pa*, *sh-* etj., janë disa nga formantët që kanë krijuar çifte fjalësh me kuptim të kundërt me njëra-tjetrën, si: të shkruar e të *pashkruar*, *strehë* e *pastrehë*, i intrigonte *prishja* dhe *mosprishja*, me drojë e *padrojë*, të larta e të *palarta*, përfillur e *shpërfillur* etj. Por nuk mungojnë edhe ato të tipit si: *qamë* e *qeshëm*, *u hap* dhe *u qep*, *e tallte parë* e *mbrapsht qëllimirië* - *qëllimkeqe* etj., me përbërje tingullore krejtësisht të ndryshme.

Por në vepër gjejmë edhe fjalë e togje fjalësh që dalin si antonime kontekstuale, si: *Nxënësit ishin fatbardhët të lidhur me fatin e zi të artistes hungareze. Balancuan ferrin e vuajtjeve me parajsën e buzagazit. Shohin me*

*sy të zbardhur grykat e zeza të armëve.;...ishte një fjalim i përgatitur gjatë, ecengec dhe me nxitim. Sa më shumë nuk shiheshin aq më të bukura dukeshin. Pikëllimi i lë vendin diellit të buzëqeshjes.*

I natyrshëm e spontan në shkrimet e tij, i rreptë në bukurinë e ashpër të fjalës, i mprehtë në përfundimet mendore dhe i ndjeshëm në botën e tij të drejtë e të ekuilibruar, Kulla na del i papërsëritshëm në ndërtimet sintaksore të gjuhës së shkruar e të folur.

### **Lidhjet e reja të fjalëve, në rrethana të reja ligjërimore burim kuptimesh dhe ngjyrimesh stilistike**

Afrimi i fjalëve për herë të parë është përftesë që bën përshtypje. Originaliteti stilistik shpesh është një bashkim i papritur ose i ri i fjalëve (Lloshi 2005: 139). Pëllumb Kulla i vendos fjalët në lidhje të reja e i vë në rrethana të reja ligjërimore, duke ua zgjeruar edhe më tej rrethin e kuptimeve dhe të ngjyrimeve stilistike. Në këtë mënyrë ai krijon neologjizma stilistikë shumë shprehës, si për shembull: *kryekolltukun e vëmendjes, shkretëtirën e mendimit, hemoragji kombëtare, puse alegorie, pus filozofie.*

Pa u ndalur në shpjegimin dhe vlerësimin artistik të figurave letrare të ndërtuara me këto fjalë, po theksojmë se ky grup i neologjizmeve është një tregues i mjaftueshëm për të parë se si autori pasuron sistemin e figurshmërisë së sistemit të shqipes.

### **Shprehje të bukura stilistikisht, por që karikatojnë e ironizojnë ashpër**

Në përpjekje për të evidentuar të gjitha dukuritë gjuhësore që përftohen në vepër, kemi veçuar edhe disa shprehje të pjesshme e të plota, të cilat, më shumë se për bukurinë stilistike të thurjes së fjalëve, i veçuam për të treguar ndjeshmërinë gjuhësore të autorit, qëndrimin e ashpër e mospajtues, tonet e mllefrit e të arrogancës të cilat alternohen bukur me komentet ironike dhe karikaturat e shpejta të autorit që synojnë orientimin e ndjenjave në mënyrë të veçantë.

*....tregimet veshin petkat e legjendave dhe fryjnë bulçitë e furtunave armiqësore midis popujve; ...për t'i nxjerrë kallajin komunizmit të urryer kriminal.; ...plagosën për vdekje edukatën fisnike shqiptare.; ..ethja drithëruese e ambicjes për kamje.; ..mëria shkumëzonte mbi gjitonët te gardhi.; traumatizuan veshët dhe psikenë e vocërrakëve shqiptarë.; Këtyre gojërave nuk u gjen dot ilacin.; U ka ardhur gulshi dhe këlthasin.; Duhet të kesh humbur patjetër skuqjen e faqes .; u fryn flakëve të urrejtjes tonë.; Kanë humbur të kuqtë e cipës së ballit.; Dihet që dëbora e përgjegjesisë mbulon majat më të larta... Pulat ngopen dhe hambarët s'humbasin asnjë thërrime.*

*Kemi sy e shohim, gojë e ua përmendim, dhëmbë dhe i zbardhim.; Të gjithë sulen jo te grazhdi ku ushqehet lopa, por te sisët e saj.; Të lumtë çiftja e grepi që zure këto perla! Vendit i ka mbetur veza kryq. etj.*

### Fjalë e shprehje të leksikut popullor

Nuk do të lëmë pa përmendur këtu edhe përdorimin e fjalëve të leksikut popullor, të ligjërimit bisedor apo fjalë të vjetra të cilat flasin qartë për natyrën e thjeshtë, tepër popullore të autorit i cili i përdor ato me sqimë, në vendin e duhur, duke krijuar me lexuesin një marrëdhënie të ngrohtë, afërie, saqë duket sikur rreshtat e shkruar nga autori janë ato çfarë mendon lexuesi i veprës. Të tilla janë fjalët: *defter, biçim (partie), (një) takëm (shqiptarësh), refene, çart,(sjell) rrëzomën, zbruqet, sus, sorolopi, sefte, kukumalen, (hyri në) potere, mesele,(me) okë, (gjuhë) allasoj, telekos,( pa) teklij, (karakter) çapraz, sënduk, paçavure, çapëlojnë (sytë), të cilat shoqërohen edhe nga një ngjyrim i veçantë stilistik dhe emocional.*

### Frazeologjia

Pas letërsisë artistike, stili i publicistikës është ai që mbështetet më shumë në gjuhën e folur, prandaj ka si tipar të dallueshëm leksikun e frazeologjinë e pasur dhe sintaksën e larmishme të ligjërimeve popullore (Thomai 1992: 175). Shprehja e qartë dhe e bukur nuk arrihet pa njohjen dhe përpunimin me mjeshtëri të të gjitha mjeteve të gjuhës letrare kombëtare e sidomos të burimeve popullore.

Është e dallueshme aftësia e shkrimtarit për të qëmtuar e thithur atë që ka më të fortë e ndikuese goja e popullit, gjykimin e mençurinë e tij të sintetizuar në thëniet urtake. Kujdesin për gjuhën autori e tregon edhe në përdorimin e frazeologjisë.

Frazeologjia mbetet gjithmonë një arë që sa herë të punohet aq më shumë prodhime cilësore jep. E duke e njohur mirë këtë shtresë të leksikut, Pëllumb Kulla do të arrijë të japë nuanca të shumta të mendimeve dhe të ndjenjave, duke e bërë kështu gjuhën shumë evokuese dhe ndikuese. P.sh.: *i patën shitur për një copë bukë, pa i hyrë gjemb ferre në këmbë, t'u hedhim ca hi syve, i vajti mendja, i piku në mend, e bënë gjak, se të erdhi vafti, të pjellë belaja, hahej dhëmbë për dhëmbë, i hipën delli, s'ka nga ta zëri qeni, të bëjmë gropën, do të bëhet gjaku deri në gju, në burg për shtate palë qejfe etj.*

Urtia popullore, ndjenja e hollë gjuhësore e krijuesit të madh, të mishëruara në këto shprehje të shkurtra, i japin ligjërimit bukuri e larmi të këndshme (Thomai 1999: 239).

Nga ana tjetër këto njësi frazeologjike përforcojnë me intesitet të lartë, ku dhe kur duhet mendimet e autorit. Duke u mbështetur në struktura të tilla të njësive frazeologjike autori ndërton edhe vetë modele shprehjesh, si: *diktatura që po kërkoi unë me fener (qiri) në dorë, do ta linte duarzbrazur mortjen e zezë, duke sharë bot e qyt diktaturën, dhuntia e madhe të bëhet gjyle. Politikanët e moralshëm e drejtojnë gishtin nga mund të zgjidhet filli e jo ku ndodhet lëmshi etj.*

### Fjalët e huaja

Përsa i përket fjalëve të huaja dihet që ato janë të pranishme në gjuhën e sotme letrare, ato janë përbërës të natyrshëm në gjuhë, pa prani në e të cilave nuk mendohet edhe zhvillimi i shqipes standarde.

Fjalët e huaja që janë përdorur në vepër janë shumë të pakta, gjë që tregon qartë se nevojat e autorit për shprehësi i plotëson më së miri shqipja letrare me mjetet e saj të shprehjes, por ato janë fjalë nga gjuhë të ndryshme, gjuhë të publicistikës, të cilat autori i njeh mirë e i përdor në vendin e duhur. Të tilla janë fjalët e huaja janë:

- (a) nga latinishtja, si: *torpedo, detonojnë, veneracion, perfiditetin, interlokutori, okelio, intimidim, abrogimin, preliminare, kompasionale;*
- (b) nga frëngjishtja: *enturazhi, suzhetet;* nga italishtja: *arranxhator, mesagjer;*
- (c) nga anglishtja: *linçoi;*
- (ç) nga greqishtja: *arkizotërat, paravolira, gjerarkët, stratagjema.*

### Përfundim

Është thënë sa herë, vepër të mirë me gjuhë të dobët nuk ka. *Luftë pa fund* është një sukses në fushën e publicistikës dhe jo vetëm. “Vepra është një leksion i hapur për studentët, për gazetarët, për intelektualët, për mënyrën si duhet t’i përkasin shoqërisë” (Çakuli – Baze 2013: 4), por pas këtij studimi të gjuhës së veprës, pa asnjë mëdyshje, themi se *Luftë pa fund* është edhe një leksion për gjuhën shqipe, për përdorimin mjeshtëror të pasurisë së saj leksikore e frazeologjike në fushën e publicistikës nga autori.

Shkrimtari Pëllumb Kulla, me shkrimin e kësaj vepre në shqip, s’bëri gjë tjetër, veçse vërtetoi edhe njëherë vlerësimin e E. Koliqit për gjuhën shqipe: “E gjuha jonë më duket e vetmja që mundet me shpreh ndiesit tash të forta gadi deri n’egërsi, tash të buta deri n’amëlsi, të majtuna e të turrëshme, qi shpirti i Shqiptarëve burra ushqen here mbas here. Gjuha shqipe asht e bukur pse asht burrnore e prandej fisnike, zemërake dhe krenare” (Koliqi 2, 2003: 297-298).

Në mbyllje të këtij punimi, po me zellin dhe përkushtimin e nevojshëm që e nisëm, theksojmë se vendi ynë është me fat që ka

shkrimtarë të tillë, arti, letërsia dhe publicistika gjithashtu, por më me fat duhet të ndihen gjuhëtarët e gjuha shqipe, e cila përmes penës së Pëllumb Kullës afirmohet si një gjuhë e pasur dhe e begatë, si një hambar me drith të bollshëm, që herë pas here duhet të shohitet për të gatuar bukë të reja e të shijshme.

### **Bibliografi:**

- ÇAKULI, Filip, BAZE, Mero (2013), *Parathënie e veprës Luftë pa fund*, Tiranë.
- ISLAMAJ, Shefkije (1985), *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë.
- KOLIQI, Ernest (2003), *Vepra 2, 5*, Faik Konica, Prishtinë.
- LLOSHI, Xhevat (2005), *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, SHBLU, Tiranë. Nga konferenca e mbajtur në Kolegjin Saverjan, më 18 janar 1931. Shih E. Koliqi, "Vepra", 2, Konica, Prishtinë, 2003.
- PARANDOVSKI, J. (1964), *Alhemija reči*, Beograd.
- SAMARA, Miço (1985), *Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- SHEHU, Hajri (1989), *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe III*, Tiranë.
- SHKURTAJ, Gjovalin (2009), *Pesha e fjalës shqipe*, Tiranë.
- THOMAI, Jani (1999), *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- THOMAI, Jani (1992), *Teksti dhe gjuha*, Tiranë.
- ULLMAN, Stephen (1962), *Semantics Introduction to the Science Meaning*, Oxford.

### **Përmbledhje**

*Studimi synon të hulumtojë disa veçori gjuhësore e stilistike të veprës Luftë pa fund, të shkrimtarit, regjisorit, publicistit, Pëllumb Kulla. Në ditët e sotme gjuha e publicistikës ka afrim të ndjeshëm me gjuhën e gjallë dhe kjo jep frytet e veta si rruga kryesore për të shmangur frazeologjinë e zbrazët, shabllonet, përsëritjet, shprehësinë e konsumuar e letrarizmat.*

*Begatia leksikore dhe frazeologjike e gjuhës së veprës, kompozitat origjinale të autorit, si edhe dukuri të tjera gjuhësore janë hulumtuar dhe është vlerësuar aftësia që shkrimtari ka, jo vetëm për ta zotëruar mjeshtërisht gjuhën shqipe, por edhe për ta përdorur atë me zhdërvjelltësi e inteligjencë në arritjen e qëllimeve tij si shkrimtar.*

*Dukuri të tilla, si: kompozitat origjinale të shkruara njësh e me vizë në mes, mjetet gjuhësore me funksion karakterizues, përshkrues e cilësues, fjalët e prejardhura, fjalët e përngjitura, fjalët e shprehjet e leksikut popullor, frazeologjia etj., janë ilustruar me shembuj të shumtë nga vepra.*

*Po kështu, janë ilustruar me shembuj edhe dukuria e sinonimisë dhe e antonimisë. Të gjitha këto dukuri të studiuara me kujdes dëshmojnë potencialin gjuhësor të autorit që edhe pse u bën vite që jeton larg ardeut, vazhdimisht kontribuon në fusha të ndryshme të artit, letërsisë e publicistikës përmes gjuhës shqipe, gjuhë të cilën ai e pasuron dhe shndërron në "armën" e tij më të fortë.*

**Fjalët çelës:** kompozita origjinale, fjalët e prejardhura, fjalët e përngjitura, fjalët popullore, frazeologjia, sinonimet, antonimet.

### **Summary**

*The study aims to explore some linguistic and stylistic phenomena of "Endless war", written by Pëllumb Kulla, a writer, film director and publicist. Nowadays the publicistic language is a sensitive approach to the lively language and this gives its fruits as the main route to avoid the empty phraseological, templates, repetition, and the consumed expressions.*

*The lexical and phraseological wealth of the language used in the work of the art, the original compositives of the author, even other linguistic phenomena is being explored and is being estimated. This proves the ability that the author possesses, not only by mastering the albanian language, but also by using that ability with intelligence in achieving his purpose as writer.*

*Such phenomena like: original compositives written either fully or with hyphen linguistic means functioning as characterisers, describers and crossfierrss, derivate words, attached words and folkloric words, phraseology and so on are illustrated by lots of examples from the book. In the some way there are illustrations including synonyms and antonyms.*

*All these phenomena, carefully studied, testify for author's linguistic potencial who even though has been living abroad for a long time, still contributes to several areas of art, literature and publicity. He does this through albanian language, wich he enriches and transforms in his most powerful "weapon".*

**Key words:** original compositives, derivate words, attached word, folkloric word, phraseology, synonyms, antonyms.